



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot: Broj Prot: Prot.No:	15-10169
Nr. i faqeve Br.stranica No.pages	4
Datum: Date:	26/12/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: SKRININGU I ATROFISË MUSKULARE SPINALE (SMA)

PËRMBAJTJA: PËRSHKRIMI I PROCEDURAVE NË PROCESIN E SKRININGUT TË PORSALINDURVE PËR ATROFI MUSKULARE SPINALE


VERSIONI:[1.0]
DATA E APROVIMIT [24/12/2024]
AUTOR [GP/MSh/ShSKUK]
NR. I HAPAVE [VI]
NR. I NËNHAPAVE [26]

APROVUAR: Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



QËLLIMI	KJO PROCEDURË KA PËR QËLLIM TË PËRSHKRUAJ HAPAT PREJ MARRJES SË GJAKUT TE ÇDO I PORSALINDUR, GRUMBULLIMIN E MOSTRAVE, TRANSPORTIN E TYRE DERI NË LABORATOR (QKUK/SHËRBIMIN E MIKROBIOLOGJISË KLINIKE/QKUK), ANALIZËN LABORATORIKE TË TYRE DHE RAPORTIMIN E REZULTATEVE TË FITUARA PËR SMA.
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ul style="list-style-type: none"> • LIGJI NR 04/L125 PËR SHËNDETËSI • PLANI I SKRININGUT NEONATAL • STRATEGJIA PËR SHËNDETIN E NËNËS, FËMIJËS DHE SHËNDETIN RIPRODHUES • PLANI I VEPRIMIT 2023-2025
LISTA E SHKURTESAVE	<p>QKUK – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS</p> <p>KOGJ – KLINIKA GJINEKOLOGJIKE OBSTETRIKE</p> <p>KPSH – KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR</p> <p>SISH – SISTEMI I INFORMIMIT SHËNDETËSOR</p> <p>SMA – ATROFIA SPINALE MUSKULARE</p>

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
I	Marrja e gjakut për analizë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjaku për skringing neonatal për SMA duhet të merret 24-48 orët e para të jetës së të porsalindurit; 2. Përgatitet materiali i nevojshëm: <ol style="list-style-type: none"> a. dorëza sterile; b. alkool 70%; c. lanceta sterile; d. gaza të thata sterile; e. test filtër; f. zarfi. 3. Sigurohu që të gjitha materialet të jenë sterile dhe gati për përdorim.
II	Proceduara e marrjes së gjakut për analizë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Paraprakisht plotësohen të dhënat në letrën e test filtër; 2. Vendosen dorëzat sterile; 3. Thembra e të porsalindurit pastrohet me alkool 70%; 4. Punktohet me lancetë sterile (shih foto) <div style="text-align: right; margin-top: 10px;">  </div> 5. Pika e parë e gjakut pastrohet me gazë të thatë sterile; 6. Gjaku merret nga thembra me letër filtër; 7. Mostra e gjakut duhet të qëndroi së paku dy orë në ambient dhome pa ekspozim direkt në dritën e diellit; 8. Mostra e tharë e gjakut vendoset në zarf.
III	Grumbullimi mostrave	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mostra e tharë e gjakut në letër filtri e vendosur në zarf dërgohet në laboratorin e Skringingut të të porsalindurve brenda 48 orëve; 2. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohen të dhënat e Institucionit që e dërgon mostrën; 3. Zarfi i mbyllur vendoset në kuti transporti dhe dërgohet në Shërbimin e Mikrobiologjisë klinike/QKUK; 4. Mostrat nga Maternitetet e KPSH-së duhet të dërgohen në spitalin e përgjithshëm më të afërt brenda 24 orëve ku grumbullohen me mostrat tjera nga Spitali; 5. Mostrat nga Spitali dhe KOGj dërgohen në Shërbimin e Mikrobiologjisë klinike/QKUK ; 6. Mostrat nga institucionet private dërgohen direkt në Shërbimin e Mikrobiologjisë klinike/QKUK.

IV	Pranim/Dorëzimi i mostrave dhe përpunimi/ analiza e mostrave	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mostrat nga tereni pranohen në laborator nga tekniku laborant përgjegjës, i cili i evidenton mostrat e pranuar; 2. Pas pranimit të mostrave stafi i laboratorit ndjek procedurat profesionale për përpunimin dhe analizën e mostrave për skringun për SMA.
V	Përpunimi dhe njoftimi i rezultateve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rezultatet interpretohen nga profesionistët / Mikrobiologu dhe evidentohen; 2. Rezultatet evidentohen edhe në databazë për skring neonatal; 3. Për rezultatet pozitive (të dyshimta) për SMA duhet të njoftohen institucionet nga të cilat është pranuar mostra e gjakut, përmes postës elektronike; 4. Institucioni përkatës (Materniteti, Spitali i Përgjithshëm, Klinika e Neonatologjisë dhe institucioni privat) obligohet të njoftoi prindin, bazuar në të dhënat e plotësuar paraprakisht në mostrën e marrë (përmes telefonit, adresës elektronike etj); 5. Profesionisti shëndetësor në institucion (pediatri) pas vizitës mjekësore dhe konsultimit njofton prindin për rezultatin e dyshimtë dhe e udhëzon për hapat e mëtejshëm; 6. Rastet e dyshimta referohen për trajtim të mëtejshëm (analiza shtesë për konfirmimin e diagnozës apo rezultat eventual rrejshëm pozitiv) te Pediatri-Neurolog në QKUK.
VI	Databaza/ raportimi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Databaza e të gjitha rasteve të përfshira në skring neonatal përgatitet nga Departamenti i SISH-it dhe siguron qasje në këtë databazë për të gjitha institucionet ku ndodhin lindjet.